



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.70/2019
Prishtinë, më 25.6.2019, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Glauk Konjufca, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe anëtarë. I pranishëm, Sali Zyba, deputet.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Lutfi Zharku, Liburn Aliu dhe Duda Balje, anëtare.

I ftuar: Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Pjesëmarrës të tjerë: Nebih Shatri dhe Argjend Zejnaj, MIT; Syzana Jagxhiu Zyra e BE-së; Ardiana Tusha, KDI; Shpëtim Haziri, GPLDK, Vatra Qehaja, GPVV; Dardan Abazi, INDEP; Marigona Bajrami, GPPSD; Taulant Osmani, BIRN dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Veton Raci, si dhe praktikanti Afrim Berisha.

Mbledhjen e kryesoi, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 18 dhe 19.6.2019;
3. Raportim i z. Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 18 dhe 19.6.2019

Procesverbalet nga mbledhjet e datës 18 dhe 19.6.2019, u miratuan pa vërejte.

3. Raportim i z. Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave

Kryetarja– Lidhur me këtë pikë, kemi diskutuar në mbledhjet e kaluara, më 19 të këtij muaji, ishte e ftuar ambasadorja Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësuese e Posaçme e BE-së në Kosovë, ku diskutimi ishte lidhur me monopolin në fushën e homologimit të veturave/barriera jotarifore për importin e veturave të reja që kanë origjinën nga BE-ja. Po ashtu, kur është shqyrtuar raporti vjetor i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, është ngritur si debat monopoli në fushën e homologimit të veturave. Për këtë çështje, është i ftuar z. Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, të cilit ia dha fjalën, për të diskutuar për monopolin në fushën e homologimit të veturave.

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Për ta njohur këtë temë, na u duhet një vështrim i shkurtër për rëndësinë e këtij procesi dhe për mënyrat sesi është rregulluar kjo fushë në shtetet e BE-së. Çdo mjet i prodhuar jashtë vendit, duhet të pajiset me certifikatë të homologimit apo përshtatshmërisë së mjetit me standarde teknike për përdorim të sigurt të mjetit në rrugët e vendit, si një vend që aspiron anëtarësimin në BE. Ne i zbatojmë të gjitha standardet e BE-së, në fushën e përshtatshmërisë së automjeteve për përdorim rrugor. Pra, të gjitha automjetet që prodhohen në BE, kanë standarde teknike, të cilat janë të pranueshme në vendin tonë. Industria e prodhimit të automjeteve është shpërndarë në shumë vende, prandaj në secilin shtet ekziston një autoritet i veçantë për verifikimin e përshtatshmërisë së automjeteve për përdorimin rrugor. Kështu autoritetet homologuese ekzistojnë në: Suedi, Belgjikë, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Britani të Madhe, Letoni, Luksemburg, Holandë, Kroaci etj. Në të gjitha këto vende, autoritetet homologuese bëjnë verifikimin e përshtatshmërisë së automjeteve të importuara për përdorim rrugor. Në vendin tonë, homologimi i automjeteve ka filluar nga viti 2009. Autoriteti përgjegjës për homologim është MIT-ja, ndërsa subjekt i autorizuar për homologimin e veturave është “Euro Labi”, që vazhdon ushtrimin e kësaj veprimtarie. Ky etnitet ishte autorizuar nga ministri i Transportit në vitin 2008, edhe për mirëmbajtje të bazës së të dhënave të automjeteve. Pra, mund të them që nuk jemi ne që e kemi autorizuar, por ka qenë para 10 viteve dhe ju deputetë të nderuar, e keni sponsoruar edhe Ligjin për automjete, që ka qenë kryesues z. Muhamet Mustafa, i këtij komisioni, ministër ka qenë z. Lutfi Zharku. Në muajin maj të vitit 2017, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për automjete, numër 05/L132, me të cilin është vendosur korniza ligjore për homologim të automjeteve. Autoriteti përgjegjës dhe kushtet për subjekte autorizuara, në kapitullin 3 të këtij ligji, gjendet dispozita për homologimin e automjeteve, të llojit dhe tipit të homologimit dhe përjashtimet në nenin 32, përcaktohet se autoritetet përgjegjës për homologim është MIT-ja. Neni 33, përcakton funksionet e subjekteve të autorizuara për homologim dhe detyrat e tyre, ndërsa në nenin 34 paraqiten kushtet që duhet të plotësohen nga këto subjekte dhe afati i vlefshmërisë së autorizimit të lëshuar nga ministria, për homologim të automjeteve. Sipas këtij neni, në paragrafin 1 thuhet : Subjektet e autorizuara për homologim duhet të kenë kushtet hapësinore, materialo-teknike, kuadër profesional, organizim të punës dhe strukturë

organizative, pajisje teknike dhe informatike dhe kushte tjera, të cilat përcaktohen me akte nënligjore”. Në paragrafin 2 të këtij neni, thuhet: “Subjekti i cili plotëson kushtet nga paragrafi 1, i lëshohet licenca me afat të pakufizuar”. Ua përkujtoj që ju jeni deputetë të nderuar, që e keni votuar dhe ia keni dhënë mundësinë që të mos të ketë kohë të kufizuar dhe nuk jam unë që e kam nënshkruar këtë ligj, nuk është MIT-ja, por jeni ju që e keni pasur përgjegjësinë e MIT-së, ka qenë vetë ministri z. Zharku, por edhe kryetar i komisionit ka qenë z. Muhamet Mustafa. Unë nuk i kam fajet që keni prodhuar këtë ligj. Unë, si ministër i MIT-së, jam i obliguar që me përpikëri të implementojmë ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Prandaj, në këtë drejtim, mund të them që mbi këtë bazë, MIT-ja ka nxjerrë udhëzimin administrativ 02/18, për homologimin e automjeteve, i cili pasi ka kaluar të gjitha procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, ka hyrë në fuqi në muajin prill të vitit 2018. Por, tani na duhet fizibiliteti dhe ne kemi kërkuar nga Komisioni Evropian, që të kemi ekspertë dhe po në këtë ligj, mendoj që janë të saktësuara ato sipas udhëzimit që e kemi nxjerrë nga ligji dhe mund të them lirshëm, që edhe TAIEX-i, që e kemi këtu tani edhe çështjen teknike, që është përgjegjës z. Nebih Shatri, i cili ka qenë i autorizuar të merret me këtë çështje. Ne jemi munduar që mos të kemi monopol dhe po në këtë komision që është nga TAIEX-i, asnjë vend nuk përmendet monopoli, por thotë se duhet të filloj plotësim-ndryshimi i ligjit dhe pastaj edhe udhëzimi administrativ. Për çfarëdo vendimi rreth plotësim-ndryshimit të ligjit, unë jam i thirrur të nxjerr edhe udhëzimin administrativ, por kushtet apo licencimin ia keni dhënë ju, në bazë të ligjit, që është neni 34 pakufizuar. Pra, nuk guxojmë ta ndërpremë dhe të hapet tregu për të tjerat. Sa i përket çmimit, e them prapë, është i nënshkruar nga dy ish-ministrat, ish- ministri z. Limaj dhe ish-ministri i Financave, Ahmet Shala. Prej atij momenti as s’kam ndryshuar ligj, as s’e kam pasur ndërmend ta ndryshoj. Pagesa është 84 euro dhe 74 cent, plus TVSH-ja, e këtë e kanë bërë para 8 viteve ish- ministrat e lartcekur. Në fund, tha se po e presim vetëm fizibilitetin dhe udhëzimi administrativ nuk e krijon monopolin, por përkundrazi e hap tregun për qendra të homologimit.

Hykmete Bajrami– Diskutimi rreth homologimit ka filluar shumë herët në komision. Në administratë kam dërguar një kërkesë, shumë kohë para se të vijë Agjencia e Konkurrencës për raportim dhe znj. Apostolova, që të ftohet ministri, por nuk është ftuar asnjëherë që të vijë e të raportoë, pikërisht për udhëzimin administrativ. Ministër, ligjin e kemi para vetës, nuk ju kemi ftuar për ligjin. Ligji nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, ligji nuk i garanton në asnjë dispozitë një subjekti ekonomik monopol. Ju i keni disa letra nga znj. Apostolova. Ne e kemi ngritur çështjen në Kuvend, por deklaratat tona nuk po merren parasysh, si zakonisht, dhe në asnjë letër të znj. Apostolova nuk flitet për ligjin, por flitet për udhëzimin administrativ 02/2018 dhe ajo ishte këtu prezent, prezent ishim ne dhe mediat. Të gjitha ankesat e Bashkësisë Evropiane janë drejtuar udhëzimit administrativ 02/2018. Ne e dimë që kontrata e kaluar ka qenë e dëmshme dhe mezi kemi pritur që kjo kontratë të skadojë dhe të hapet tregu për operatorë të rinj. Ajo çka ju e keni bërë, është se e keni betonuar udhëzimin administrativ dhe keni bërë vazhdimin e monopolit në përjetësi. Ju keni thënë se në udhëzimin administrativ që subjekti i cili për momentin e ka licencën, e tani do të ju pyesim se çka do të ndodh më datën 2.7.2019, duhet t’i shfrytëzoj 85% të kapaciteteve në mënyrë që ministria e infrastrukturës ta bëjë një studim të fizibilitetit për të shpallur konkursin për operatorë të r?! Ndërkohë që në nenin 34 normalisht që për ta pasur licencën për homologim dhe për mbikëqyrje profesionale të qendrave teknike të kontrollit për të cilën ju askund nuk flisni në udhëzimin administrativ. Pra ajo që thuhet në nenin 34 dhe 38 absolutisht nuk i garanton monopol asnjë subjekti, ndërkohë që neni 88 paragrafi 2 thotë që të gjitha qendrat e kontrollit teknik mund të aplikojnë në ministri të infrastrukturës për tu pajisur me një licencë të tillë. Problemi kryesor është pse duhet të homologohen veturat e reja të cilat prodhohen në shtetet evropiane dhe kjo pyetje është ngritur nga qytetarët para se të ngritet nga znj. Apostolova dhe ambasadorët tjerë. Pra, ku është

problemi që nuk pranohen certifikatat e konformitetit, të lëshuara me standarde të BE-së? Problemi tjetër është monopoli. Ju, zoti ministër, e thatë vetë që udhëzimin administrativ e keni nënshkruar më 12.4.2018 dhe ka hyrë në fuqi 7 ditë më vonë. Si ka mundësi që prej asaj kohe deri më tani nuk keni bërë studimin e fizibilitetit, a nuk është e qëllimshme kjo, që më datën 2.8. 2019, në mënyrë automatike “Euro Labit”, që të gjithë e dimë kush qëndron prapa saj, t’i vazhdohet monopoli? Çka nënkuptoni ju me 85% shfrytëzim të kapaciteteve, a nuk ka mundësi operatori i tanishëm të rrisë kapacitetet dhe gjithmonë t’i lë 15% të kapaciteteve të pashfrytëzuara, në mënyrë që asnjëherë konkurrenca të mos hyjë aty? Si ka mundësi që ne në Kosovë kemi 110 qendra të kontrollit teknik dhe asnjëherë nuk flasim për koston që qendra e homologimit merr nga kontrollet teknike? Ajo nuk e ka licencën vetëm për homologim, e ka licencën edhe për mbikëqyrje profesionale të qendrave të kontrollit teknik, e secila qendër e kontrollit teknik, që janë 110, për secilën veturë i paguan 5 euro qendrës për homologim. Këto janë para që qytetarët i paguajnë për kontrolle teknike dhe këto para shkojnë në llogari të qendrës për homologim. Gjejeni një nen të vetëm në Ligjin për automjete që i vazhdon monopolin? Ne, sipas Kushtetutës, jemi ekonomi e tregut të lirë. Pse nuk i licenconi 10 apo 20, aq sa ka ofertë dhe pastaj të veprohet në bazë të ligjit?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Përgjegjëse keni qenë ju, për 3 vite, kur keni qenë në Qeveri dhe po e njëjta kompani ka pasur të kryejë shërbimet dhe ju jeni prapë, ju them sponsorues të ligjit ekzistues dhe ligji nuk e përkufizon as në 10 ditë, as në 2 vite, por ligji ia mundëson të pakufizuar afatin. Në bazë të këtij ligji, unë kam të drejtën, në bazë të udhëzimit administrativ, që t’ia jap licencën, mund të tërhiqet licenca, në bazë të kontrollit të komisionit, që e ka të vazhdueshëm në çdo kohë dhe ato janë të ministrisë dhe ligji ia ka dhënë Ministrisë së Infrastrukturës, për t’i bërë kushtet në bazë të ligjit. Dhe e them me përgjegjësi të plotë, që udhëzimi administrativ është derivat i ligjit dhe nuk është asnjë pikë jashtë ligjit ekzistues, që ju e keni sponsoruar. Pse nuk e keni ndërprerë në kohën tuaj? Prandaj, ligji është problem, ndryshojeni ligjin ju, menjëherë pas ndryshimit të ligjit, unë ia ndërpres kontratën. Ne, pas letrës së znj. Apostolova, kemi kërkuar ekspertë të jashtëm, që të bëjmë fizibilitetin dhe është formuar komisioni që ka dhënë rekomandime.

Kryetarja– Është e qartë që Kosova është e përcaktuar për ekonomi të tregut të lirë dhe me krejt infrastrukturën ligjore dhe njerëzore, që të luftojë monopolin dhe të ketë konkurrencë, prandaj jemi këtu për ta zgjidhur një çështje kaq të ndjeshme dhe jo të shndërrojmë në debate personale.

Hykmete Bajrami– Kontrata që është në fuqi e ka afatin 1.7.2009 - 1.7.2019. Kontrata, kur është nënshkruar, ka qenë një ligj tjetër, pra kur është nënshkruar. Neni 88, paragrafi 2, thotë se të gjitha qendrat e kontrollit teknik mund të aplikojnë për licenca. A keni shprehur interes që t’u jepet licenca të tjera për homologim? Neni 34, thotë se ata të cilët e marrin licencë nëpër aq kohë sa i plotësojnë kushtet, mund ta mbajnë licencën. Nuk e kontestoj që operatori që është tani në treg nuk i plotëson kushtet, mirëpo pyetja është: çka keni bërë ju që t’ia heqin monopolin kësaj kompanie?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Ne kemi shprehur interes dhe komisioni ka shkuar, i ka monitoruar komplet kapacitetet ekzistuese dhe komisioni ka vlerësuar se i plotëson kushtet dhe ligji ia ka mundësuar vazhdimin e kontratës. Lidhur me këtë, kërkoj që t’i jepet fjala drejtorit të Departamentit të Automjeteve, për sqarime profesionale.

Nebih Shatri, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit– Së pari, të sqarojmë se çka është homologimi. Kosova nuk kryen homologim, ta keni të qartë, sepse e kam dëgjuar edhe ambasadorin Apostolova. Pra, ata që nuk e njohin mirë lëmin dhe në momente të ndryshme dalin jashtë teme. Kosova bën vetëm verifikim të kushteve, sepse automjeti ri duhet të bëjë verifikimin. Disa mundohen ta paraqesin si barrierë jotarifore. Të njëjtën shprehje e përdor edhe ambasadori gjerman, i cili thotë se është çmimi më i lartë në rajon, që bie brenda fjalisë së vet në kundërshtim. D.m.th. paska edhe në vendet tjera homologim. Ne nuk kryejmë homologim, ne e njohim homologimin evropian. Homologimin evropian e kryejnë shtete të caktuara, në bazë dëshmisë që e lëshojnë, që ky automjet i plotëson kushtet dhe kur vjen te ne, ne e bëjmë verifikimin se a është i njëjti automjet me atë që është ofruar në dokumentacion. Kjo është ajo që bëjmë ne dhe që e bëjnë të gjitha shtetet e rajonit. U përmend, pse studimi i fizibilitetit? Është shumë interesant, loja e dyfishtë e znj Apostolova. Ne kemi ardhur dhe jemi marrë vesh, e kemi sqaruar që kemi nevojë për arsye që mos të na ndodhë si me qendrat e kontrollit teknik. Jemi duke folur për institucionin që është duke e ofruar ndihmë. Kontributi i tyre është shumë i madh dhe pasojat për vendin janë shumë të mëdha, nëse ndërpritet një-anshëm, sepse e kemi bazën e të gjitha automjeteve, duke filluar nga viti i prodhimit, lloji i prodhimit, ndërtimin dhe të gjitha kushtet që janë, i kemi në atë bazë dhe kemi marrë lëvdata nga Banka Botërore, sepse në afat rekord iu janë ofruar të gjitha shënimet që ata i kanë kërkuar. Të kthehemi prapë te studimi i fizibilitetit. Ne kemi kërkuar që të vijnë ekspertë të Bashkimit Evropian, ta shikojnë a ka ndokund barrierë ose nëse kemi diçka në legjislacion, që nuk është në rregull. Cilat janë propozimet e tyre, që ta ndryshojmë apo ta përmirësojmë gjendjen? Ka ardhur kërkesa nga ta, që të propozojmë ekspertë. Ne kemi propozuar ekspertë dhe kemi kërkuar që të ketë domosdoshmërisht ekspertë suedezë dhe anglezë, sepse ka qenë më herët një raport që e ka punuar GAP-i, i financuar nga ambasada suedeze dhe angleze. Kemi kërkuar që për kryesues të kemi një gjerman, i cili është eksperti më i mirë në këtë fushë për Evropë, por ka ardhur përgjigjja, se nuk kemi mundësi t'i paguajmë këta, por do të vijnë dy nga Latvia. Mirëpo, prapë nuk iu kemi përzier në përzgjedhjen e ekspertëve. Dhe në fund, siç e keni parë ju, pas katër ditë punime, ata e kanë propozuar, si të gjetura, rreth të cilave duhet të punohet një raport. Unë e kam parë këtë dokument, më 20 qershor 2019, për herë të parë, edhe pse kam qenë porosites i këtij dokumenti. D.m.th. asnjë draft-raport nuk ka ardhur, veç për ilustrim kam marrë si duket një raport që e kanë bërë ekspertët tjerë, e jo sikurse ky që e kanë punuar këta tani. Pra, kështoj, paraprakisht është dërguar draft-dokumenti për komente, se mos nuk kemi kuptuar diçka dhe pastaj e ka marrë formën përfundimtare. Ky raport nuk ka ardhur në ministri fare. Ka ardhur prej znj. Apostolova në Ministrinë e Integritetit dhe nuk ka ardhur te ne. Unë e kuptoj këtu çka shkruan, por 99% nuk e kuptojnë çka shkruan, ku thotë: “Në përgjithësi, Kosova nuk bën miratimin e tipit të mjetit ose Kosova i zbaton kërkesat për mjetet e reja dhe të përdorura sipas kërkesës teknike të BE-së, para regjistrimit, por nuk bën kontrollet në bazë të kërkesave më të fundit teknike, si dhe nuk ka përcaktuar kërkesa konkrete të kontrolleve teknike”. Pra, ky raport nuk është raport, ky mund të jetë një dokument i atyre që kanë raportuar, çka kanë punuar, por raporti i ekspertëve nuk është i këtillë.

Muharrem Nitaj– Juve ju shohin përgjegjës, sepse doni ta vazhdoni kontratën me “Euro Labin”. Përmendet data 2.7.2019 dhe kontrata 10 vjeçare, a ka kontratë 10 vjeçare apo nuk ka dhe nëse ka, kush e ka nënshkruar, a është e vërtetë që ju mund ta vazhdoni kontratën edhe për një 10 vjeçar tjetër? E dyta, juve ju shohin përgjegjës z. ministër që po e pamundësoni konkurrencën në treg dhe që po e mbron monopolin e një kompanie. Ju po thoni që keni filluar procedurat e studimit të fizibilitetit. Çka nënkupton kjo dhe kur tregu në Kosovë mund ta ketë edhe një operator tjetër në afat kohor? Dhe e treta, a ka mundësi të na lexoni nenin 34, pikën 2 se çka shkruan, a është e vërtetë ajo që ju thoni që ky ligj i jep leje në afat të pacaktuar apo është ndryshe?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Sa i përket përgjegjësisë, nuk e ndjej vetën përgjegjës, sepse nuk e kam nënshkruar kontratën para 10 viteve, por e kam gjetur të nënshkruar për 10 vite nga ish- ministri, z. Fatmir Limaj. Sa i përket opinionit të po këtyre që e kanë sponsorizuar ligjin dhe që e kanë pasur përgjegjësinë në të kaluarën, dhe po e përsëris, ka qenë ministër z. Lutfi Zharku, ndërsa kryetar i këtij komisioni ka qenë z. Muhamet Mustafa, që e kanë proceduar në Kuvend dhe po këta deputetë e kanë miratuar ligjin. Po ashtu, tani e citoj nenin 34, pikën 2, i cili thotë:“ Subjekti i cili i plotëson kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, i lëshohet licenca me afat të pakufizuar”. Sa i përket monopolit, ju garantoj që ne pas shikimit që i kemi bërë ligjit, kemi nxjerrë udhëzimin administrativ dhe në bazë të përgjegjësive që i ka ministria, e kemi hartuar udhëzimin administrativ, i cili i ka kaluar të gjitha procedurat. Pas reagimit të ambasadores, znj. Apostolova, në letrën e cila e përmend Devollin, që ka qenë përpilues i ligjit dhe udhëzimit administrativ, e që në asnjë nen e në asnjë paragraf nuk e ka përmendur monopolin, por është shtrembërim i asaj që do të krijojë një opinion negativ te qytetarët dhe ne i kemi kërkuar që të kemi ekspertë të fushës që të kryejmë fizibilitetin, që të bëjmë hapjen e tregut. Ju garantoj të gjithëve, që pas kryerjes së fizibilitetit, ne do ta bëjmë hapjen e tregut. Po ashtu, ju them me plot përgjegjësi, që në atë moment që bëhet ndryshimi i ligjit, unë do ta zbatojë plotësisht. Sa i përket konkluzioneve të TAIEX-it, procesi i regjistrimit të mjeteve të reja ka shkelje ligjore në bazë të dispozitave të direktivave të 2007/46, neni 4 dhe 26 dhe direktivës 2014/45 neni 1, është i detyrueshëm vetëm për mjetet e regjistruar, duhet të ndryshohet kapitulli 5 neni 30 dhe 33 të Ligjit për automjetet dhe nenet 7, 11,17 të udhëzimit administrativ. Pra paraprakisht ka kërkuar konkluzione që të fillohet procedura për amendamentimin e neneve plotësim-ndryshimi i neneve dhe ligjit, pastaj si derivat i këtyre të ndryshohet edhe udhëzimi administrativ. Unë nuk mund të veproj ndryshe. Sa i përket kontratës, prapë e them që ligji ia jep të pakufizuar kohën, por e them që ne jemi për treg të hapur dhe të mos ketë monopol dhe e them këtë para qytetarëve që kjo do të ndodhë.

Glauk Konjufca –Nuk e kuptoj vetëm një gjë, pse e ndërlikojmë një gjë shumë të thjeshtë? Kjo është çështje e thjeshtë. Pajtohem secili këtu që ju nuk e keni bërë krimin kryesor. Krimi kryesor është në vitin 2008, njëjtë sikur me “Z Mobile”, është nënshkruar një kontratë në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me nenin 119, ku i jepet drejtpërdrejt një përfituesi privat monopol në fushën e homologimit apo verifikimit teknik të automjeteve, por për këtë proces, me një vendim të ministrit, është krijuar duke i shkelur të gjitha procedurat edhe të prokurimit publik. Ky është krimi i parë. Krimi i dytë është ky, kushdo që ka pasur vullnet politik dhe e ka kuptuar krimin, shumë është lehtë për ta ndalur këtë krim, sepse i ke të gjitha autorizimet që t’i jep Kushtetuta dhe ligji dhe s’ka pse të ndryshohet ligji, kontrata ka lidhje. Së pari, te ligji i ke të gjitha shprehjet në shumës, jo në njëjës. Pra, mund të jenë 4, 5 apo më shumë operatorë. Ju, me udhëzim administrativ, ia keni përshtatur operatorit dhe me vendimin tuaj, më 1.7.2019, do t’ia vazhdoni monopolin operatorit të njëjtë, sepse i skadon kontrata. Ju i keni kompetencat që ta ndërpritni këtë kontratë. Për këtë kontratë, ke mundur të kesh probleme, nëse e kishit shkelur në vitin 2015 ose 2016, ndonëse unë jam shumë i bindur, që kurrë, asnjë arbitrazh, Kosova nuk e kishte humbur për këtë rast, sepse është në shpërputhje me Kushtetutën e Kosovës, përkatësisht me nenin 119, i cili e garanton konkurrencën dhe tregun e hapur në Republikën e Kosovës, ndërsa ju thoni që “Euro Labi” e ka kontratën e pakufizuar, e nuk mund ta ketë kontratën e pakufizuar. Ju, me këtë, e keni shkelur Kushtetutën e Kosovës. Z. Lekaj, nëse Kuvendi i Kosovës e merr një vendim në seancë që ju ta anuloni udhëzimin administrativ, a do ta anuloni udhëzimin administrativ?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Duhet të iniciohet amendamenti dhe plotësim-ndryshimi i ligjit, përndryshe unë nuk marrë asnjë veprim dhe nuk më obligon mua rezoluta as Kuvendi që ta anulojë, sepse mua më obligon ligji.

Glauk Konjufca– Ju jeni duke e vazhduar monopolin dhe jeni duke i ikur përgjegjësisë, a mund të më përgjigjesh z. ministër, “Euro Labi” a ka monopol të pakufizuar, sipas teje?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Nuk ka monopol të pakufizuar operatori i cekur nga ju.

Glauk Konjufca– A e keni vendimin e Autoritetit të Konkurrencës, i cili ka thënë që ky udhëzim është në kundërshtim me ligjin?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Nuk është në kundërshtim me ligjin dhe tani po ua cek çka thotë TAEX-i, po e citoj: “Informacionet dhe pikëpamjet e përcaktuara në këtë raport i përkasin autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë opinionin zyrtar të BE-së”. Unë nuk e kam shkruar këtë, ata e kanë thënë, prandaj mos e jani në mbledhje, pa i lexuar këto raporte.

Glauk Konjufca– Z. Lekaj, na tregoni sa para i keni marrë prej “Euro Labit”, që ta bëni këtë udhëzim? Sepse, dikush ka marrë para në vitin 2008 dhe dikush po merr para prapë në 2019, sepse ky vendim nuk mund të merret, pa pasur ndonjë interes të drejtpërdrejtë dhe kjo është vepër penale. Në përpilimin e udhëzimit tënd administrativ, a ka pasur çfarëdo kontakti në çfarëdo mënyre publike apo edhe takime të fshehta në mes jush dhe përfaqësuesit të “Euro Labit”, sepse kështu ka thënë znj. Apostolova?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Për këtë fjalë mund të shkoni në gjykatë, nëse keni argumente paraqitni para qytetarëve, por nëse nuk keni argumente, atëherë do të ballafaqohemi në gjykatë, sepse kurrë në jetën time nuk kam keqpërdorur asnjë cent dhe nuk kam asnjë interes këtu.

Kryetarja– Për akuza dhe vepra penale nuk është komisioni parlamentar dhe Kuvendi, ku duhet të orientoheni, janë organet tjera shtetërore ku mund të drejtoheni dhe mund të shkoni t’i paraqitni, prandaj ju lutem fokusoheni në temë.

Salih Zyba– Kam disa pyetje krejt teknike për ekspertin tuaj, që e keni këtu prezent, kur është i punësuar në pozitën që e ka, i njëjti a ka të hyra familjare nga pronarët, në këtë rast nga “Euro Labi”? A e ka shkruar shteti këtë udhëzim, se ju e di që jo? A e keni kontratën e shumëpërfolur, e rrezikshme dhe shumë e dëmshme? A e keni lexuar kontratën, çka thotë neni që ia vazhdon afatin dhe pse nuk e keni sjellë këtu, sot? Këtë udhëzim s’e ka bërë as eksperti yt, por e ka bërë pronari që është duke përfituar atje, sepse thujse secilin kriter apo kusht teknik, duke filluar nga parkingu, kuzhina, administrata, klima etj., ia keni përshtatur atij operatori.

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Ne, si ministri, jemi të obliguar të kemi kriter në standarde evropiane dhe edhe TAIEX-i e ka thënë qartë, që ne jemi nën kriteret e BE-së dhe si ministri, nga e cila derivon udhëzimi administrativ, që e ka lejuar ligji dhe po e them që nuk ka kontratë nga unë, atë kontratë e posedoj dhe mund ta merrni kur të doni në arkiv. Nëse ma gjeni fjalën monopol në raport, unë marrë përgjegjësi, prandaj ligji ma mundëson që të japë në afat të pakufizuar licencën dhe asgjë më shumë ose më pak.

Në atë moment që fillon plotësim-ndryshimi i ligjit, unë jam për ta respektuar ligjin, ashtu siç ai më obligon. Unë përgjigjem vetëm prej ditës që kam marrë detyrën.

Muharrem Nitaj– Ju u përgjigjet, se po bëni studimin e fizibilitetit dhe keni angazhuar ekspertë. Problemi është që a do të vazhdojë ta ruajë monopolin apo do ta liberalizoni tregun, në bazë të ligjit që do t’ua mundësoj. Pra, kur do të bëhet liberalizmi i tregut?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– E them me përgjegjësi të plotë, që tregu do të liberalizohet dhe nuk do të ketë monopol, por duhet sikur për qendrat teknike që janë 110, që ka një kriter në një komunë, duhet të ketë 4 mijë automjete që të ketë një qendër teknike dhe tani pa pasur atë standard, nuk mund të them asgjë. Për dëshirën time do ta bëja sot, por nuk guxoj të shkoj në atë nivel, që të shkatërroj komplet sistemin dhe ju them që deri në fund të vitit, do ta kemi një pasqyrë. Në janar do të fillojmë të aplikojmë qendrat tjera të homologimit. Prandaj, jam për kriteret dhe të liberalizohet tregu. Sa i përket ekspertit tim, unë e di që ka qenë sekretar permanent, nuk ka konflikt interesi, por nëse ka, ky e merr përgjegjësinë jo unë.

Memli Krasniqi– Ligji për automjetet është ligj i keq. Po ashtu, është e vërtetë që Ligji për automjetet është bërë në mandatin e kaluar. Ju, zoti ministër, keni qenë deputet, ndërsa unë e znj. Bajrami kemi qenë ministra. Nuk dua të flas shumë për z. Zharku që ka qenë ministër, i cili do të mund të na i jepte disa shpjegime, por sot nuk është këtu. Pastaj, z. Muhamet Mustafa ka qenë kryetar i këtij komisioni. Ligji është i keq, sepse e kemi filluar një plotësim-ndryshim të atij ligji dhe s’jemi në gjendje ta kryejmë që 7 apo 8 muaj, nuk po mundemi të miratojmë disa gjëra që e përmirësojnë, një prej të cilave ka qenë limitimi i importimeve të veturave deri në 10 vite, që është bërë për interesa të caktuara. Pra, një prej gjërave që po mundohemi të ndryshojmë është pikërisht cenimi i tregut të lirë që është bërë me atë ligj, jo te homologimi, por te kontrolli teknik. Ajo që përmendet ju është cenim i nenit 119 të Kushtetutës, sepse thotë nuk bën të hapen kontrole tjera teknike. Këtu krejt jemi për treg të lirë, por në seancë nuk janë, nuk e voton askush as amendamentet që janë duke u sjellë rreth 8 muaj. Një prej tyre e kam bërë unë me disa kolegë, ua kemi hequr komplet kushtet limituese, që t’ua mundësojmë që kush dëshiron të hapë kontrole teknike, sepse ne përnjëmend jemi për treg dhe konkurrencë të lirë. Mendoj që edhe për homologim duhet të ketë mundësi të konkurrencës së plotë. Pra, këtu mund të argumentohet që ka monopol, sepse ka vetëm një kompani që është duke ofruar shërbimin, mirëpo legalisht nuk ka monopol. Sepse monopole ka nganjëherë legalisht, por të pronësia intelektuale dhe kjo ndodhë edhe në vende tjera të botës dhe është në rregull, por tek ofrimi i shërbimeve nuk është në rregull dhe për këtë arsye duhet të krijohet një hapësirë që duhet të ketë më shumë operatorë. Ndërsa, një gjë tjetër që është vështirë të kuptohet dhe të arsyetohet këtu, mendoj që duhet të ketë reflektim ministria. Këto certifikatat e konformitetit që i lëshojnë shtetet e BE-së, për disa vetura, në frymën e MSA-së, ishte dashur të pranohen me automatizëm. Personalisht, jam i skandalizuar me nenin 34, pika 2, sepse ai ligj është që 3 vite aty, prandaj mendoj që ky ligj duhet të ndërrohet urgjentisht, sepse edhe raporti i TAIEX-it, thotë që duhet të ndryshohet kapitulli 5 i nenit 33 të Ligjit të automjeteve dhe të udhëzimit administrativ, nenet 7,11 dhe 17, ndërsa, ajo që më bëri përshtypje është se, pse këta nuk kanë rekomanduar që të ndryshohet neni 34, do të ishte me rëndësi ta dimë, pse nuk e kanë rekomanduar edhe këtë nen të ndryshohet?

Pal Lekaj, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit– Sa i përket kontingjentit të automjeteve që vijnë, që janë të certifikuara nga BE-ja apo prodhuesit, ne vetëm një automjet e verifikojmë dhe jo tërë kontingjentin, dhe për këtë pajtohemi me ju z. Krasniqi.

Memli Krasniqi– Pyetje shitesë, a vlen kjo vetëm kur blihen me shumicë apo vlen për cilindo importues p.sh. nëse një importues i blen gjatë vitit 100 vetura, por nuk i merr të gjitha përnjëherë, por i merr herë 5 herë 10, a vlen kjo edhe për këto gjatë tërë vitit?

Nebih Shatri, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit– Janë dy lloje të homologimit ose miratimit, është individuali dhe tipori. Tipor kanë të drejtë vetëm importuesit e autorizuar për një tip të automjetit dhe kjo vlen për krejt seritë që prodhohen. Me ligjin tonë, automjetet e reja shkojnë në kontrollim teknik. Kjo ka qenë vërejtje e ekspertëve që nuk ka nevojë që automjeti i ri të shkojë në kontroll teknik.

Hykmete Bajrami– Nga të gjitha diskutimet tona, ata që i kanë përcjellë, e kanë vërejtur qartë kush është pro edhe kush është kundër homologimit. Z. ministër, asnjë nen dhe asnjë gjykatë nuk mund të vërtetojë që ligji ekzistues e vazhdon monopolin. Ju e keni vazhduar monopolin me udhëzim administrativ, neni 7, paragrafi 4 i udhëzimit tuaj administrativ 02/2018. Po ashtu, z. Ministër, ju keni thënë se “Euro Labi” duhet të shfrytëzojë mbi 85% të kapaciteteve në tri vitet e fundit, në mënyrë që të hapet tregu për subjekte të reja. Këtë e keni thënë që duhet t’ia thotë ministrisë një kompani që ju e kontrakti për studimin e fizibilitetit Tani, më tregoni a keni bërë studim të fizibilitetit në tri vitet e fundit? Sepse, e keni pasur të paraparë që kontrata skadon më 1 korrik, e cila është 1.7.2009 deri 1.7.2019. Ju e keni ligjin në fuqi, i cili në asnjë nen të vetëm nuk flet për një subjekt, flet për subjektet. Neni 88, pika 2 e ligjit në fuqi për automjete, thotë: “Të gjitha qendrat e kontrollimit teknik mund të aplikojnë të marrin licenca”. Pse z. Ministër, keni pritur që dy vite dhe pse “Euro Labi” duhet të shfrytëzojë 85% të kapaciteteve? Neni 119, pika 3 e Kushtetutës e thotë ekonomi e tregut të lirë, që nënkupton se rregullon oferta dhe kërkesa nëse operatorët ekonomikë kanë leverdi të hyjnë në sektor, hyjnë, nëse nuk kanë nuk hyjnë, por asnjë shtet nuk e cakton të thotë se ju keni për të shfrytëzuar 85% të kapaciteteve që ta hapim tregun për operatorë tjerë, kështu që mos u mundoni të na hidhni hi sy neve e as qytetareve, mos u fshihni pas ligjit, sepse që dy vite keni mundur ta bëni studimin e fizibiliteti dhe shprehjen e interesit. Sa i përket Ligjit për automjete, është i sponsorizuar prej një deputeti të Grupit Parlamentar të PDK-së. Ai ligj e ka një qëllim, të hiqet kufizimi i vjetërsisë së veturave, që kemi qenë kundër, sepse ajo është bërë që të mbrohet ambienti. Pra, edhe sot jemi kundër dhe ka dy propozime, që asnjëri nuk i përmbush kushtet tona që të votohet. Kam kërkuar nëse kemi mundësi të hyjmë dhe të plotësojmë e ndryshojmë nenet tjera dhe na është thënë që nuk mundemi, vetëm ato që i ka propozuar sponsoruesi.

Muharrem Nitaj – E kuptuam gatishmërinë tuaj për liberalizim të tregut, vetëm mos u fshihni prapa kritereve dhe të thoni pas 6 muajve që këta të tjerët nuk i plotësuan kriteret, kështu që u detyruam t’ia vazhdojmë kontratën vetëm një operatori, sepse e gjithë hilja mund të luhet këtu, nuk e them prej jush, mirëpo hilja mund të luhet në emër të kritereve. E njëjta është edhe te mbrojtja e monopolit në fushën e kontrolleve teknike, ku është kërkuar liberalizimi i tregut. Pra, edhe në fushën e kontrolleve teknike, ka pasur një kërkesë dhe arsye se pse duhet të liberalizohet tregu. Në aspektin rajonal, ka kompani që punojnë në Han të Elezit, ndërsa biznesin e kanë në Prishtinë dhe gjithë makinerinë e rëndë detyrohen ta sjellin në komunën ku e kanë të regjistruar biznesin, që të bëjnë kontrollet teknike. Një prej arsyeve, pse është kërkuar liberalizimi edhe në aspektin territorial, ka qenë kjo kërkesë e shumë palëve.

Kryetarja– Ju kujtoj deputetëve se komisioni mund të dërgojë rekomandime, vetëm përmes Kuvendit dhe jo në formë tjetër. Ne mund t’i dërgojmë ministrit rekomandim, që ta shfuqizojë udhëzimin administrativ dhe sa e zbaton ai atë kërkesë nuk e di. Po ashtu, ne nuk mund të ndërhyjmë në legjislacion sekondar, sepse nuk e nxjerr Kuvendi.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, të dorëzojë një kopje të kontratës së homologimit të veturave, e vendosur në vitin 2008, nënshkruar nga ministri dhe përfaqësuesi i ndërmarrjes “EURO LAB”.

4. Të ndryshme

Kryetarja njoftoi deputetët se KDI ka propozuar që ne, si komision, pasi që e kemi vizituar ARKEP-in, dhe tani do ta vizitojmë edhe Telekom-in, për t’u informuar se a po zbatohet kodi i ri telefonik i Kosovës “+383”. Prandaj, ta caktojmë bashkërisht datën kur mund të shkojmë si komision.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetares.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA